



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE
DREJTORIA E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT
TË ADMINISTRATËS PUBLIKE

Lënda: Kthim përgjigje të kërkesës për informacion mbi pagesën e diplomave “Master profesional”

ZNJ. K. J. GJ.

Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, protokolluar me tonën nr. 3647, datë 8.7.2024, nëpërmjet së cilës kërkon sqarim në lidhje me kriteret e ndjekura për: (i) vlerësimin me kredite të arsimit universitar të kryer para viteve '90, si dhe (ii) vlerën e shtesës së nivelit të kualifikimit, ju sqarojmë si vijon:

Referuar vendimit nr. 325, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nënpunësve civilë dhe nënpunësve në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar, “shtesa e nivelit të kualifikimit” është një ndër elementet e pagës bruto mujore të nëpunësve që trajtohen me pagë me këtë vendim. Kjo shtesë shpërblen nivelin arsimor të kërkuar për pozicionin përkatës të punës, bazuar në arsyetimin se cili është niveli minimal arsimor që mundëson që nëpunësi në pozicionin përkatës, të mund të ketë njohuritë e domosdoshme për të realizuar detyrat që i ngarkohen. Në këtë drejtim, janë mbajtur në konsideratë edhe përcaktimet e ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ku ndër të tjera sanksionohet si vijon:

“Programet e ciklit të parë të studimit, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, organizohen me jo më pak se 180 kredite europiane (ECTS) dhe kohëzgjatja normale e tyre është tri vite akademike.

...

Cikli i dytë i studimeve përfshin programet e studimit “Master i shkencave”, “Master i arteve” dhe “Master profesional”, referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

Programet e studimit “Master i shkencave” pajisin të diplomuarit me njohuri të thelluara teorike, si edhe me aftësim për kërkim shkencor në një fushë të caktuar. Këto programe organizohen në:
a) programe që realizohen me jo më pak se 120 kredite formimi në vijim të ciklit të parë dhe me kohëzgjatje normale dy vite akademike;

...

DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE

Programet e studimeve “Master profesional” pajisin të diplomuarit me njohuri të thelluara, profesionale në një fushë të caktuar. Këto programe organizohen me 60 ose 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është një vit ose dy vite akademike.”

Shtesa e nivelit të kualifikimit është e ndarë në tre grupe, me tre vlera të ndryshme, që përcaktohen në lidhjen nr. 2, të VKM-së nr. 325/2023, të ndryshuar. Për çdo nëpunës, vlera e shtesës së nivelit të kualifikimit aplikohet në përputhje me diplomën që ai/ajo ka, e konkretisht:

Grupi i diplomës	Niveli i kualifikimit sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK)	Vlera e shtesës së nivelit të kualifikimit (lekë/muaj)
1	Niveli 7 KSHK (Master i Shkencave. Master i Arteve. Master Profesional të përfutur në fund të studimeve të ciklit të dytë, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike. Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.)	14 000
2	Niveli 7 KSHK (Master Profesional. Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.)	12 000
3	Niveli 6 KSHK (Bachelor. Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.)	10 000

Sa më lart, në konkluzion sqarojmë se, programi i studimit “Master profesional i përfutur në fund të studimeve të ciklit të dytë, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike” është vendosur në grupin 1 të diplomës, për shkak të nivelit të krahasueshëm të njohurive dhe aftësive të përfutura në fund të këtij programi studimi, me ato të përfutura në kuadër të programit të studimit “Master i shkencave”.

Ndërkohë, sa i takon pikës së parë të kërkesës suaj, në lidhje me kriteret e ndjekura për ekuivalentimin dhe vlerësimin me kredite të diplomave të përfutura para viteve ’90, siç jeni vënë në dijeni, Departamenti i Administratës Publike e ka përcjellë kërkesën pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, si autoriteti kompetent për adresimin e saj.

Duke Ju falenderuar për mirëkuptimin!